



# Tax Changes 2019

Tax News Albania

Audit / Tax / Advisory / Accounting / Consulting

Smart decisions. Lasting value.

# Tax Changes - 2019

A Summary on tax amendments effective from 2019 in Albania



## PROCEDURAT TATIMORE

Amendime në ligjin “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

### **Transaksionet me subjektet tatimore në regjistrin pasiv**

Çdo transaksion me subjektet tatimore në regjistrin pasiv, i kryer nga tatimpaguesit aktivë, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet si më poshtë:

- shitësi (tatimpaguesi aktiv) – gjobë 10,000 lekë për çdo transaksion të kryer;
- blerësi (subjekti tatimor pasiv) – detyrim tatimor plus gjobë 100% të vlerës.

Administrata tatimore qendrore publikon në faqen zyrtare të internetit të DPT dhe përditëson mbi baza ditore listën e tatimpaguesve në regjistrin pasiv.

### **Metodat alternative të vlerësimit**

Administrata tatimore ka të drejtë të përdorë metodat alternative të vlerësimit në përcaktimin e detyrimit tatimor të transaksionit, në rastet kur:

- a) transaksionet e kryera nga tatimpaguesi deformojnë parimet e ligjit tatimor;
- b) transaksionet nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut;
- c) transaksionet nuk kanë efekte ekonomike thelbësore;

d) forma e transaksionit nuk reflekton thelbin e tij ekonomik;

e) evidentohen elemente të transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore.

### **Pagesa e detyrimit tatimor, objekt ankimi**

Pagesa ose vendosja në garanci bankare për kamatëvonesat nuk do të jetë më kusht për ankimin e një njoftim vlerësimi tatimor pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor/ Komisionit për Shqyrtimin e Apelimeve Tatimore.

Përpara këtij ndryshimi, kamatëvonesat së bashku me detyrimin shtesë duhej të ishin të paguara apo të vendosura si garanci bankare përpara ankimit të njoftim vlerësimit.

### **Deklarimi i pasaktë i tepricës kreditore**

Që nga 1 janari 2019, rivlerësimi në ulje i tepricës kreditore, i kryer nga administrata tatimore, do të jetë subjekt i gjobës 20% të diferencës ndërmjet tepricës kreditore të deklaruar nga tatimpaguesi dhe asaj të rivlerësuar nga administrata tatimore.

### **Penalitetet për mosnjoftimin e ndryshimeve të pronësisë sipas Ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”**

Për mosnjoftimin në administratën tatimore të ndryshimeve të pronësisë, sipas kërkesave të nenit 27/1, “Ndryshimi i pronësisë”, të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” vendosen penalitete që variojnë nga 5-15% të vlerës së tregut të aktiveve që janë subjekt i ndryshimit të pronësisë.

## TATIMI MBI TË ARDHURAT

### Tatimi mbi dividendin dhe shpërndarjen e fitimeve

Tatimi mbi dividendin/fitimet që ju shpërndahen aksionarëve/ ortakëve bëhet 8%.

Kjo normë tatimi do të zbatohet nga shoqëritë rezidente në Shqipëri mbi fitimet e pashpërndara, të realizuara në vitet 2018 e më parë, përfshirë rezervat, me kusht që:

- i) Tatimi mbi dividendin, për fitimet e pashpërndara deri në fund të vitit 2017, të paguhet brenda datës 30.09.2019; ndërsa
- ii) Tatimi mbi dividendin për fitimin e vitit 2018 të paguhet brenda datës 20.08.2019.

### Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi

Rritet niveli i sipërm i të ardhurave nga punësimi që taten me normën 13%, nga 130,000 Lekë/muaj në 150,000 Lekë/muaj.

Skema e re për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi ndryshon si më poshtë:

E ardhura e punësimit e	Norma e tatimit mbi të ardhurat
0 - 30,000	0%
30,000 – 150,000	+13 % të shumës mbi 30,000 Lekë
150,000 – e sipër	15,600 Lek + 23% e shumës mbi 150,000 Lekë

### Shtesa në dispozitat ekzistuese

Do të konsiderohen si të ardhura nga një burim në Republikën e Shqipërisë, të ardhurat si më poshtë:

- Të ardhurat nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme, aksesorët dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat nga të drejta të tjera, nga pronësia mbi sendet e paluajtshme, në rast se këto sende ndodhen në territorin Republikës së Shqipërisë;
- Të ardhurat nga tjetërsimi i pasurisë dhe të drejtave përmendur në pikën më sipër;
- Të ardhurat e një personi jorezident, të përfutuara si rezultat i shërbimeve të kryera për një person rezident.

“Nga data 1 Janar 2019 norma e tatimit mbi fitimin për taksapaguesit me qarkullim vjetor nga 8 milion deri në 14 milion lekë bëhet 5%.”

## **Shtohet neni 27/1 “Ndryshimi i pronësisë”**

Nëse gjatë një periudhe tatimore pronësia direkte dhe/ose indirekte e kapitalit aksionar, kuotave, apo e të drejtave të votimit të një personi juridik, i cili për tre vitet paraardhëse, ka realizuar mesatarisht një qarkullim vjetor prej 500 milionë lekë, ndryshon me më shumë se 20% në vlerë ose numër aksionesh, kuotash, personi juridik trajtohet sikur ka shitur një pjesë proporcionale të të gjitha pasurive të tij menjëherë përpara ndryshimit. Personi juridik trajtohet si:

- a) Përfitues i të ardhurave nga shitja, e barabartë kjo me pjesën proporcionale të vlerës së tregut të aktivitetit në atë kohë; dhe
- b) Riblerës i aktivitetit për të njëjtën vlerë.

Kur një person juridik paguan tatimin mbi fitimin, të ardhurat nga ndryshimi i pronësisë së aksioneve ose interesave të ngjashme, që shkaktojnë ndryshimin, janë të përjashtuara nga tatimi mbi fitimin.

Një person juridik, subjekt i ndryshimit të pronësisë, duhet të njoftojë autoritetet tatimore me detajet e ndryshimit brenda 45 ditëve nga data kur ka ndodhur ndryshimi. Në rast të mosnjoftimit, tatimpaguesi bëhet subjekt penalizimi.

## **Në kategorinë “Shpenzime të panjohura” (neni 21) shtohet:**


- Shpenzimet për dieta që tejkalojnë 50 për qind të fondit të pagës bruto vjetore.

Shtohet neni 30/1 “Deklarimi dhe pagesa nga personat joresidentë specifikë”:

- Një person joresident, detyrohet të përgatisë një deklaratë të të ardhurave të tatueshme, sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat.

## **Tatimi mbi fitimin për biznesin e vogël**

Nga data 1 Janar 2019 norma e tatimit mbi fitimin për taksapaguesit me qarkullim vjetor nga 8 milion deri në 14 milion lekë bëhet 5%.



## TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR

### **Në transaksionet me shkallë të reduktuar TVSH-je shtohen:**

- Furnizimi i shërbimit të reklamave nga media audiovizive bëhet 6%;
- Furnizimi i mjeteve të transportit publik të udhëtarëve me autobus me dhjetë vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik:
  - o 6% deri me 31 dhjetor 2021,
  - o 10% nga 1 janar 2022;
- Furnizimi i librave të çdo lloji bëhet 6%.

### **Në kategorinë “Përrjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm” shtohen:**

- Furnizimi i makinave bujqësore, i inputeve bujqësore dhe disa furnizime të shërbimeve veterinarë. Lista e makinerive bujqësore që përfitojnë përcaktohet me VKM.

### **Në kategorinë “Përrjashtime të veçanta në import” shtohen:**

- Importimi i lëndëve të para për prodhimin e barnave, me përrjashtim të lëndëve me përdorim të dyfishtë, të kryera nga mbajtësit e autorizimit të prodhimit, sipas legjislacionit të fushës për barnat. Lista e lëndëve të para për prodhimin e barnave përcaktohet me VKM.

### **Në kategorinë “Eksportet” ka ndryshime në furnizimet si më poshtë:**

- Furnizimet e shërbimeve të përpunimit të mallrave të destinuara për rieksporim, nga personat e tatueshëm të autorizuar dhe nënkontraktorët e tyre për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv trajtohen si eksporte dhe shkalla e aplikuar e TVSH bëhet 0%.

## AKCIZA

### **Shtesa në dispozitat ekzistuese**

- Prej datës 1 Janar 2019 produktet të cilat kategorizohen si “Duhan i grirë” do të tregtohen vetëm me pullë fiskale dhe për rrjedhojë pulla fiskale do të aplikohet mbi këtë kategori produkti;



- Importimi dhe prodhimi i letrës së cigareve do të kryhet vetëm nga subjektet grumbulluese-përpunuese të duhanit të cilat janë të pajisura me linja me cikël të plotë përpunimi dhe paketimi për tregtim.

## KONTRIBUTET E SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDËTËSORE

### Paga minimale

Këshilli i Ministrave miratoi vendimin “Mbi përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, sipas të cilit nga data 1 janar 2019, paga minimale bëhet 26,000 lekë dhe paga maksimale për efekt të kontributeve shoqërore bëhet 114,670 lekë.



## Contact Information

Hysen Cela  
Country Managing Partner  
Hysen.Cela@crowe.al

Crowe AL sh.p.k  
Rruga Brigada 8, P. 8/1, Ap. 14

+355 682026191  
+355 692026191  
info@crowe.al

NUIS/ NIPT: K31516059K

For more information,  
scan QR code below:



## About Us

Crowe AL shpk, a full member of Crowe Global, which is ranked among the top 10 global accounting networks with more than 150 independent accounting and advisory services firms in over 100 countries around the world, is a professional firm organized in the form of a limited liability company that operates in the field of auditing and assurance, accounting, review, tax advice, business valuations, due diligences, risks and other consultancy services. It was established in Tirana, Albania in 2002 and approved by the Albanian Institute of Authorized Chartered Auditors (IEKA) The firm was registered with the Resolution of the IEKA Registration Commission No. 40 date 10.01.2003, as an audit firm, licensed to carry out statutory audits and other related services for various types of commercial business entities, including government and non-for profit organizations.

[www.crowe.al](http://www.crowe.al)